



"Top Albania" sh.a

*Blv "Bajram Curri"
QNK "Pjetër Arbërori"
Tiranë*

*E-mail: contact@topalbaniaradio.com
Website: www.topalbaniaradio.com*

PASQYRAT FINANCIARE

VITI 2014

(Se bashku me raportin e auditimit)

Tiranë, më MAJ 2015

Pasqyrat Finaciare te vitit 2014

Permbajtja :

Raporti I auditimit	faqe 1-2
Pasqyra e Pozicionit Financiar	faqe 3-4
Pasqyra e Te ardhurave dhe shpenzimeve	faqe 5
Pasqyra e Fluksit te parase	faqe 6
Pasqyra e ndryshimit te kapitalit	faqe 7
Informacione te pergjitheshme	faqe 8-18

Raporti i Audituesit të pavarur

Drejtuar: Shoqërise "TOP ALBANIA" SH.A.
Asamblesë së Aksionereve
Bulevardi Deshmoret e Kombit,
Qendra Nderkombetare e Kultures
Tiranë

Te nderuar zonja dhe zoterinj,

Ne kemi audituar pasqyrat financiare te shoqerise "TOP ALBANIA" SH.A. të cilat përfshijnë

- bilancin kontabël me 31 Dhjetor 2014,
- pasqyrën e te ardhurave dhe shpenzimeve,
- pasqyrën e ndryshimeve ne kapital dhe
- pasqyrën e lëvizjes së mjeteve monetare

të përgatitura për periudhën ushtrimore që mbyllet më datën 31.12.2014, si edhe te politikave (metodave) me te rëndesish me kontabel dhe shenimeve te tjera shpjeguese qe shoqerojne keto pasqyra.

Përgjegjësia e drejtimit për pasqyrat financiare.

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare që nuk kanë anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi ose nga gabimi; zgjedhjen dhe zbatimin e metodave të përshtatshme kontabël; dhe kryerjen e çmuarjeve kontabël të arsyeshme për rrethanat.

Përgjegjësia e audituesit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë e kryejmë auditimin për të arritur sigurinë e arsyeshme për faktin nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale.

Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencën e auditimit rreth shumave dhe informacioneve shpjeguese të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimi apo të gabimit. Gjatë bërjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që ka të bëjë me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të

Aluza *Aluza*

entitetit, në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Një auditim përfshin, gjithashtu, vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe të arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, sikurse edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Opinionit

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë, pozicionin financiar të Shoqërisë "TOP ALBANIA" SH.A. me datën 31 Dhjetor 2014, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Shqipërisë.

AUDITUESI

Nexhmije CELA EKR
Rr. Brigata VIII, P.8/1, Ap.14, Tiranë

Fatime ALLIU EKR
Rr. Luigj Gurakuqi, pallati 8, shkalla 1, k6, ap.21 Tiranë

11 Maj 2015



I. Pasqyra e Pozicionit Financiar

AKTIVET	Ref.	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
I Aktive Afatshkurtra			
1 Mjetet Monetare	6	2.128.759	5.543.082
2 Derivate dhe Aktive Financiare te mbajtur per tregtim			
a) Derivatet			
b) Aktivete e mbajtur per tregtim			
Totali		2.128.759	5.543.082
3 Aktive te tjera Financiare afatshkurter	5		
a) Llogari kerkesa te arketueshme		66.608.922	59.967.696
b) Llogari kerkesa te tjera te arketueshme		3.525.085	1.931.124
c) Instrumente te tjera borxhi		8.737.559	33.000.000
d) Investime te tjera financiare			
Totali		78.871.566	94.898.820
4 Inventari	4		
a) Lendet e para		87.129	87.129
b) Inventari imet		1.557.941	1.557.941
c) Produkte te gatshme			
d) Mallra per rishitje		5.937.280	5.937.280
e) Parapagesat per furnizime			
Totali		7.582.350	7.582.350
5 Aktive Biologjike afatshkurter			
6 Aktive Afatshkurtra te mbajtur per shitje			
7 Parapagime dhe shpenzime te shtyra		7.972.650	
Totali Aktiveve Afatshkurtra		96.555.325	108.024.252
II Aktive Afatgjata	3		
1 Investime financiare afatgjata			
a) Aksione dhe pjesemarrje te tjera ne njesi te kontrolluara			
b) Aksione dhe investime te tjera ne pjesemarrje		-	-
c) Aksione dhe letra te tjera me vlere		-	-
c) Llogari kerkesa te arketueshme		-	-
Totali		-	-
2 Aktive Afatgjata Materiale			
a) Toka			
b) Ndertesa (neto)		20.010.732	20.212.861
c) Makineri dhe pajisje (neto)		48.501.034	53.890.038
c) Aktive te tjera afatgjata materiele (neto)		23.273.813	17.964.344
Totali		91.785.579	92.067.243
3 Aktive Biologjike Afatgjate			
4 Aktive Afatgjata Jomateriale			
a) Emri i mire			
b) Shpenzimet e zhvillimit			
c) Aktive te tjera afatgjata jomateriele		440.428	440.428
Totali		440.428	440.428
5 Kapitali aksionar i papaguar			
6 Aktive te tjera afatgjata (ne proces)			
Totali i Aktiveve Afatgjata		92.226.007	92.507.671
TOTALI AKTIVEVE		188.781.332	200.531.923



<u>PASIVET DHE KAPITALI</u>		<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
I	Pasivet Afatshkurta		
1	Derivatet		
2	Huamarrjet		
a)	Huate Overdraftet bankare	8 12.591.589	15.337.638
b)	Kthimet/Ripagimet e huave afatgjata		
c)	Bono te konvertueshme		
	Totali	12.591.589	15.337.638
3	Huate dhe parapagimet		
a)	Te pagueshme ndaj furnitoreve	8 15.536.467	29.718.979
b)	Te pagueshme ndaj punonjeseve	9 1.806.300	1.792.523
c)	Detyrimet tatimore	10 1.037.405	856.234
ç)	Hua te tjera	11 207.307	207.307
d)	Parapagimet e arketueshme	11 1.471.456	25.000
	Totali	20.058.935	32.600.043
4	Grantet dhe te ardhura te shtyra		
5	Provizionet afatshkurtra		
	Pasive Totale Afatshkurtra	32.650.524	47.937.682
II	Pasivet Afatgjata		
1	Huate afatgjata		
a)	Hua, bono dhe detyrime nga qeraja financiare		
b)	Bonot e konvertueshme		
	Totali	-	-
2	Huamarrje te tjera afatgjata		
3	Provizionet afatgjata		
4	Grandet dhe te ardhura te shtyra		
	Pasive Totale Afatgjata	-	-
	Totali i pasiveve	32.650.524	47.937.682
III	Kapitali		
1	Kapitali i aksionar	7 140.587.000	140.587.000
2	Rezerva statutore		
3	Rezerva ligjore	13.575.266	13.490.172
4	Rezerva te tjera	280.388	280.388
5	Fitimi i pashperndare	(1.848.413)	(3.465.205)
6	Fitimi (humbje) e vitit financiar	3.536.567	1.701.886
	Totali i Kapitalit	156.130.808	152.594.241
	TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT	188.781.332	200.531.923



II. Pasqyra e Të Ardhurave dhe Shpenzimeve

	Ref.	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2013
		4	
1 Shitje neto	12	73.230.341	65.309.917
2 Te ardhura te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit		-	-
4 Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit	13	(31.640.711)	(30.331.633)
5 Shpenzimet e personelit	14		
a) Shpenzimet per Pagat		(26.309.374)	(22.556.976)
b) Shpenzimet e sigurimeve shoqerore e Shendetsore		(3.566.310)	(3.151.513)
c) Shpenzimet te tjera per personelin			
6 Amortizimi dhe Zhvleresimet	15	(7.435.125)	(6.082.599)
7 Fitimi (humbja) nga veprimtarite e shfrytezimit		4.278.821	3.187.196
8 Te ardhurat/shpenzimet financiare nga njesite e kontrolluara		-	-
9 Te ardhurat/shpenzimet financiare nga pjesemarrjet			
10 Te ardhura dhe shpenzime financiare	16	(444.344)	(1.485.310)
3/a Te ardhura/shpenzime financiare nga investime te tjera financiare			
3/b Te ardhura dhe shpenzime financiare nga interesi		(445.907)	(1.474.656)
3/c Fitimi dhe humbje nga kursi i kembimit		1.563	(2.339)
3/d Te ardhura dhe shpenzime te tjera financiare		-	(8.315)
11 Totali i te ardhurave dhe shpenzimeve financiare		(444.344)	(1.485.310)
12 Fitimi (humbja) para tatimit	17	3.834.477	1.701.886
Shpenzime Te panjohura			-
13 Rezultatit Tatimore		3.834.477	1.701.886
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin		(297.910)	
14 Fitim (humbje) neto e vitit financiar		3.536.567	1.701.886



III. Pasqyra e Ndryshimit të Kapitalit

	Ne Leke					
	Kapitali i aksionar	Rezerva ligjore	Rezerva te tjera	Fitimi i pashperndare	Fitimi (humbje) e vitit financiar	Totali
Pozicioni më 31 dhjetor 2013	140.587.000	13.490.172	280.388	(3.465.205)	1.701.886	152.594.241
Efekt i ndryshimeve në politikat kontabcl						
Pozicioni i rregulluar	140.587.000	13.490.172	280.388	(3.465.205)	1.701.886	152.594.241
Shpërndarja e Fitimit të vitit 2013		85.094	-	1.616.792	(1.701.886)	-
Pozicioni më 01 janar 2014	140.587.000	13.575.266	280.388	(1.848.413)	-	152.594.241
Fitimi(humbje) neto për periudhën kontabcl 201					3.536.567	3.536.567
Rritje kapitali						-
Pozicioni më 31 dhjetor 2014	140.587.000	13.575.266	280.388	(1.848.413)	3.536.567	156.130.808



IV. Pasqyra e Fluksit Monetar

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit	3.739.138	6.193.845
Fitimi para tatimit	3.834.477	1.701.886
Rregullime për:		
Amortizimin i AAM	745.125	6.082.599
Levizjet ne Kapitali Qarkullues		
Rritje(-)/rënie(+) në tepricën e kërkesave të arketueshme nga aktiviteti, si dhe kërkesave të arketueshme të tjera	8.054.604	4.600.001
Rritje/rënie në tepricën inventarit	-	-
Rritje/rënie në tepricën e detyrimeve, për t'u paguar nga aktiviteti	(15.287.158)	(6.190.641)
Tatim mbi fitimin i paguar	(297.910)	-
Rritje/rënie në parapagime të ardhura të shtyra	-	-
Rritje/rënie në shpenzimet e shtyra	-	-
Mjetet Monetare neto nga aktivitetet e shfrytëzimit	3.739.138	6.193.845
Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese	(7.153.461)	(2.010.016)
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	(7.153.461)	2.010.016
Te ardhura nga shitja e pajisjeve	-	-
Interesi i arketuar	-	-
Dividendet e arketuar	-	-
Mjete Monetare neto e përdorur në aktivitetet investuese	(7.153.461)	(12.037.872)
Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare		
Te ardhura nga emetimi i kapitalit aksioner	-	-
Te ardhura nga huamarrje afatgjata	-	-
Pagesat e detyrimeve të qirasë financiare	-	-
Dividendet e paguar	-	-
Mjete Monetare neto e përdorur në aktivitetet financiare	-	-
Rritja (+)/rënia(-) neto e mjeteve monetare	(3.414.323)	4.183.828
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël	5.543.082	1.359.254
Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël	2.128.759	5.543.082



V. Shenimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare

1. Informacion i Përgjithshëm

Shoqëria "TOP ALBANIA" sh.a është krijuar si person juridik, në formën e Shoqërisë me Anonime Sh.a, datë 16/05/2000, me seli në adresën: TIRANË Bulevardi Deshmoret e Kombit, Qendra Nderkombetare e Kultures.

Perfaqësues ligjor është Z. Enkelejdi Joti dhe prokure te posacme Z.Ektor Pustina

NIPT: K01719005H

Objekti i kesaj shoqërie është: Veprimtari radiofonike qe perfshin prodhimin, transmetimin e programeve dhe informacioneve te cdo lloji me ane te zerit, sinjaleve te koduara, shkrimit te destinuar per publikun.

Numri i punonjesve: 38 punonjes

Kuadri ligjor: Ligji 9228 dt 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" i ndryshuar me Ligjin Nr.9477, date 09 shkurt 2006.

2. Permbledhje e Politikave Kryesore Kontabel

Mënyra e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare

Keto pasqyra financiare janë përgatitur me parimin e te drejtave dhe detyrimeve te konstatuara, sipas koston historike, me perjashtim te rasteve qe percaktohen ndryshe ne se ka te tilla.

Monedha funksionale është LEK-u shqiptar ("LEK"), valutat e huaja jane konvertuar ne Leke.

Bazat e Ndërtimit të Pasqyrave Financiare

Pasqyrat financiare jane përgatitur sipas Standarteve Kombetare te kontabilitetit (SKK-ve), përbëhen nga pozicionet financiare, të ardhurat dhe shpenzimeve, pasqyra e fluksit të parasë dhe pasqyra e ndryshimeve në kapital si dhe shënimet shpjeguese.

Konvertimi ne Monedha te Huaja

Transaksionet ne monedhe te huaj jane konvertuar ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates ne te cilin është kryer transaksioni. Aktivët dhe pasivët monetarë ne monedhe te huaj ne datën e mbylljes se bilancit jane rivleresuar ne monedhen funksionale sipas kursit te shpallur nga Banka e Shqiperise ne datën e mbylljes se periudhes ushtrimore. Diferencat qe rrjedhin si rezultat i rikonvertimit njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset zyrtare te kembimit per monedhat kryesore te perdorura ne konvertimin e gjendjeve te bilancit emertuar ne monedhe te huaj në datën e hartimit të bilancit jane si me poshte (ne LEK):

	<u>31.12.2014</u>	<u>31.12.2013</u>
Kursi i kembimit		
Euro/ Leke	140.14	140.2
USD/ Leke	115.23	101.86
Paund/ Leke	179.48	168.39

a) Instrumentat Financiare

Instrumentat financiarë te shoqërisë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, likuiditete dhe vlera arke te tjera, hua të marra dhe të dhena, dhe llogari të pagueshme.

Njohja Fillestare

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë e kushteve kontraktuale të instrumentit ne fjale. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin.

Shënimet shpjeguese janë pjesë integrale e pasqyrave financiare

8



Instrumentat financiarë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç rasteve nëse përcaktohet ndryshe. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në shpenzime dhe të ardhura.

Njohja e Metejshme

Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë maten siç përshkruhet më poshtë.

- **Paraja dhe Ekuivalentet**

Paraja dhe ekuivalentët e parasë (mjetet monetare) përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllime të pasqyrës së fluksit të parasë, paraja dhe ekuivalentët të saj përfshijnë depozita pa afat dhe ato me një maturimi prej tre muajsh ose më pak që nga data fillestare. Likuiditetet dhe vlera arke të tjera maten me tej me fitim/ humbjet nga zhvleresimet.

- **Llogari të Arkëtueshme dhe të tjera të arketueshme**

Llogaritë e arketueshme tregtare dhe të tjera nuk mbartin interes dhe paraqiten me vlerë nominale të pakesuar nga zbritjet e nevojshme për shumën që janë vlerësuar të pambledhshme. Vlerësimi i shumave të pambledhshme bazohet në gjykimin e Drejtimit.

- **Llogari të Pagueshme**

Llogaritë e pagueshme maten fillimisht me vlerën e tyre të drejtë (domethënë me kosto) dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

- **Huatë të Marra**

Huate e marre: Huatë (detyrime financiare), janë njohur fillimisht me vlerën e tregut neto nga kostot e transaksioneve dhe me pas njihen me vlerën e amortizuar. Shpenzimet e interesit të llogaritur me normën e interesit efektive (NEI) pasqyrohen në rezultat.

Norma e interesit efektive është norma që skanton saktësisht vlerat e ardhshme të parave gjatë viteve të planifikuara të detyrimit financiar ose kur është e pershtatshme, në një periudhë më të shkurtër.

Kostot e huamarrjes që lidhen drejtperdrejt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e aktiveve kualifikuese, të cilat janë aktive që kërkojnë domosdoshmërisht një periudhë të madhe kohe për t'u bërë gati për përdorimin e tyre përfundimtar ose për shitje mund të shtohen kostos së këtyre aktiveve deri në momentin që këto aktive janë kryesisht gati për tu përdorur ose shitur.

- **Netimi i Instrumentave Financiare**

Aktivitet dhe pasivitet financiarë netohen dhe shumën neto e tyre raportohet në bilanc nëse, dhe vetëm nëse ka një të drejtë të detyrueshme ligjore për të netuar shumën e njohur dhe ekziston mundësia për të shlyer në shumën neto, apo për të realizuar aktivin dhe shlyer pasivitet njëkohësisht.

- **Zhvleresime të Aktiveve Financiare**

Një aktiv financiar konsiderohet si i zhvlerësuar në ato raste kur ekzistojnë kushte objektive që tregojnë se një apo më shumë ngjarje (pas njohjes së tij fillestare) kanë efekte negative në flukset e ardhshme të parase që parashikohet të burojnë prej atij aktivi. Vështirësitë e konsiderueshme financiare të debitorit, probabiliteti që debitori do të falimentojë apo një riorganizim financiar, dhe pamundësia apo shkeljet në pagesa konsiderohen si tregues që një llogari e arketueshme është e zhvlerësuar.

- **Çregjistrimi**

Aktivitet financiarë së bashku me fondin rezervë të zhvlerësimit çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit.

Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë përfundojnë, skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

- **Transaksionet me palë të lidhura**

Palë të lidhura janë ato, kur njëra prej palëve kontrollohet nga pala tjetër ose ka influencë të rëndësishme në vendimarrjen financiare ose të biznesit të palës tjetër.

b) Provigjionet

Shënimet shpjeguese janë pjesë integrale e pasqyrave financiare



Instrumentat financiarë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç rasteve nëse përcaktohet ndryshe. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në shpenzime dhe të ardhura.

Njohja e Metejshme

Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë maten siç përshkruhet më poshtë.

- *Paraja dhe Ekuivalentet*

Paraja dhe ekuivalentët e parasë (mjetet monetare) përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllime të pasqyrës së fluksit të parasë, paraja dhe ekuivalentët të saj përfshijnë depozita pa afat dhe ato me një maturimi prej tre muajsh ose më pak që nga data fillestare. Likuiditetet dhe vlera arke të tjera maten me tej me fitim/ humbjet nga zhvleresimet.

- *Llogari të Arkëtueshme dhe të tjera të arketueshme*

Llogaritë e arketueshme tregëtare dhe të tjera nuk mbartin interes dhe paraqiten me vlerë nominale të pakesuar nga zbritjet e nevojshme për shumën që janë vlerësuar të pambledhshme. Vlerësimi i shumave të pambledhshme bazohet në gjykimin e Drejtimit.

- *Llogari të Pagueshme*

Llogaritë e pagueshme maten fillimisht me vlerën e tyre të drejtë (domethënë me kosto) dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

- *Huatë të Marra*

Huate e marre: Huatë (detyrime financiare), janë njohur fillimisht me vlerën e tregut neto nga kostot e transaksioneve dhe më pas njihen me vlerën e amortizuar. Shpenzimet e interesit të llogaritur me normën e interesit efektive (NEI) pasqyrohen në rezultat.

Norma e interesit efektive është norma që skanton saktësisht vlerat e ardhshme të parave gjatë viteve të planifikuara të detyrimit financiar ose kur është e pershtatshme, në një periudhë më të shkurtër.

Kostot e huamarrjes që lidhen drejtëpërdrejt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e aktiveve kualifikuese, të cilat janë aktive që kërkojnë domosdoshmërisht një periudhë të madhe kohe për t'u bërë gati për përdorimin e tyre përfundimtar ose për shitje mund të shtohen kostos së këtyre aktiveve deri në momentin që këto aktive janë kryesisht gati për tu përdorur ose shitur.

- *Netimi i Instrumentave Financiare*

Aktivet dhe pasivët financiarë netohen dhe shumën neto e tyre raportohet në bilanc nëse, dhe vetëm nëse ka një të drejtë të detyrueshme ligjore për të netuar shumën e njohur dhe ekziston mundësia për të shlyer në shumën neto, apo për të realizuar aktivin dhe shlyer pasivët njëkohësisht.

- *Zhvleresime të Aktiveve Financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet si i zhvlerësuar në ato raste kur ekzistojnë kushte objektive që tregojnë se një apo më shumë ngjarje (pas njohjes së tij fillestare) kanë efekte negative në flukset e ardhshme të parasë që parashikohet të burojnë prej atij aktivi. Vështirësitë e konsiderueshme financiare të debitorit, probabiliteti që debitori do të falimentojë apo një riorganizim financiar, dhe pamundësia apo shkeljet në pagesa konsiderohen si tregues që një llogari e arketueshme është e zhvlerësuar.

- *Çregjistrimi*

Aktivet financiare së bashku me fondin rezervë të zhvlerësimit çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit.

Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë përfundojnë, skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

- *Transaksionet me paletë e lidhura*

Palë të lidhura janë ato, kur njëra prej palëve kontrollohet nga pala tjetër ose ka influencë të rëndësishme në vendimarrjen financiare ose të biznesit të palës tjetër.

b) Provigjionet



Provizionet njihen kur Shoqeria ka nje detyrim aktual (ligjor ose te tërthorte) si rezultat i nje ngjarjeje te shkuar per te cilen ka mundesi qe te krijohen nje rrjedhe burimesh te nevojshme per te permbushur detyrimin dhe kur nje perlogaritje e besueshme e shumes se detyrimit mund te llogaritet. Provizionet rishikohen ne çdo date raportimi dhe nese nuk ka me mundesi per nevojen e nje rrjedhe burimesh qe perfshin perfitime ekonomike per shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren. Provizionet perdoren vetem per qellimin per te cilin jane njohur fillimisht. Pasivet dhe aktivet e kushtezuara nuk njihen, por vetem paraqiten ne shenimet e pasqyrave financiare te ndermjetme kur jane materiale.

c) Qiratë

Qirate klasifikohen si qira financiare ose qira operative qe ne fillimin e qirase. Qirate financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare ne shkallen me me te voglen midis vleres se drejte te aktivitet dhe vleres aktuale te pagesave minimale te qirase ne daten e manjes. Kosto financiare paraqet diferencen midis detyrimit total te qirase dhe vleres se drejte te aktivitet. Kostot financiare jane regjistruar ne pasqyren permbledhese te te ardhurave dhe shpenzimeve gjate kohezgjatjes se qirase me norma interesi te aplikueshme mbi balancen e mbetur te detyrimeve.

d) Inventaret

Inventaret regjistrohen ne kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes perfshin te gjitha shpenzimet e kryera per sjelljen e inventarit ne vendin e percaktuar. Ne rastin e prodhimit te produkteve, ne kosto perfshihet dhe pjesa respektive e shpenzimeve te pergjithshme duke i llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese.

e) Aktivet Afatgjate Materiale (AAM-t)

Njohja dhe Matja: Vleresimi fillestar i nje elementi te AAM-ve qe ploteson kriteret per njohje si aktiv ne bilanc eshte vleresuar me koston e marrjes ose te prodhimit te tyre. Kosto e marrjes perfshin te gjitha shpenzimet e kryera per sjelljen e aktiveve ne vendin dhe kushtet ekzistuese.

Njohja Mepashme: AAM-të paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvleresimi.

Nëse një pjesë e një elementi të AAM-së zëvendësohet, kostoja e pjesës së re i shtohet koston së elementit, nëse ajo përmbush kriteret e përkufizimit të AAM-së dhe kriteret e njohjes së aktiveve në bilanc. Pjesa e zëvendësuar do të hiqet nga bilanci edhe në se ajo nuk është kontabilizuar si pjesë më vete. Nëse kostoja fillestare (rrjedhimisht, edhe vlera kontabël aktuale) e pjesës së zëvendësuar nuk dihet ajo mund të vlerësohet në bazë të koston aktuale të kësaj pjesë minus amortizimin e vlerësuar.

Amortizimi: Per llogaritjen e amortizimit te AAM-ve njesia ekonomike ka percaktuar si me poshte :

	N/A
Ndertesa	1%
Makineri e Paisje	10%
Mjete transporti	20%
Paisje zyre dhe Informatike	5%

Tokat dhe Investimet ne process nuk amortizohen,

Ç`regjistrimi: Nje ze i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashte perdorimit apo ateherë kur nuk pritet me perfitime ekonomike te ardhshme nga perdorimi apo nxjerrja e tij jashte perdorimit. Fitimet dhe humbjet ne rastin e nxjerrjes jashte perdorimit te aktiveve afatgjata materiale percaktohen sipas shumes se tyre te mbetur dhe merren parasysh ne nxjerrjen e rezultatit operativ te ushtrimit.

Zhvleresimi (Renia ne vlere): Shoqeria nuk vlereson ne daten raportimi nese ka premisa qe nje aktiv te zhvleresohet.

f) Aktivet Afatgjata Jo-materiale (AAJM-t)

Aktivete afatgjata jomateriale perfshijne licensat, te drejtat per perdorim dhe emri i mire.

Shenimet shpjeguese jane pjesë integrale e pasqyrave financiare



Njohja dhe Matja: Liçensat, te drejtat e perdorimit te cilat perftohen nga shoqeria paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvleresimi, nese ka.

Shpenzimet Mëpasshme: Shpenzimet pasuese kapitalizohen vetem ne rastin kur shtojne perfitimet e ardhshme ekonomike te trupezuara ne aktivin specifik me te cilat ato lidhen. Te gjitha shpenzimet njihen si fitim apo humbje ne momentin kur kryhen.

Amortizimi: Amortizimi njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve duke perdorur metoden lineare mbi jetegjatesine e parashikuar te aktiveve te patrupezuara qe nga data qe jane te disponueshme per perdorim. Shoqeria nuk ka llogaritur amortizim per vitin 2014.

Zhvleresimi (Renia ne vlere): Shoqeria nuk e vlereson ne daten e raportimit nese ka premisa qe nje aktiv te zhvleresohet.

g) Të Ardhurat dhe Shpenzimet

• *Te Ardhurat*

Te ardhurat njihen ne masen qe eshte e mundur qe perfitime ekonomike do te hyjne ne Shoqeri dhe qe te ardhurat mund te maten ne menyre te besueshme, pavaresisht se kur behet pagesa. Te ardhura matet me vlere te drejte te mallit/sherbimit te shitur neto nga tatimi mbi vleren e shtuar dhe zbritje te mundshme te shitjeve.

• *Shpenzimet*

Shoqeria njih shpenzimet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve ne proporcion me kryerjen e tyre ne daten e raportimit. Shpenzimet paraqiten ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve sipas natyres se tyre, çka kerkon gjykim te konsiderueshem nga drejtimi i Shoqerise.

• *Tatimi mbi Fitimin*

Tatim fitimi apo humbjet e vitit perbehet nga tatimi aktual. Tatim fitimi njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve perveç rasteve kur lidhet me zera qe njihen direkt ne kapital, rast ne te cilin edhe tatimi njihet ne kapital. Tatimi aktual eshte tatimi i pritur per t'u paguar mbi fitimin e tatueshem te vitit, duke aplikuar normat tatimore ne fuqi ne daten e bilancit, si edhe çfaredolloj rregullimi kontabel te tatimit per t'u paguar ne lidhje me vitet e meparshme.

Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2014 dhe 2013 paraqiten me poshte:

	<u>31.12.2014</u>	<u>31.12.2013</u>
<u>Pergjindja e tatimit mbi fitimin</u>	15%	10%

h) *Dividende*

Shoqeria synon te njohe dividendet si detyrim ne periudhen ne te cilen jane deklaruar.

i) *Kapitali i Vet*

Kapitali i nenshkruar perfaqeson kontributin e ortakeve në daten e krijimit të shoqerise dhe ndryshimet gjate veprimtarise.

Kapitali aksioner njihet me vlerën nominale.

j) *Përfitimet e punonjesve*

▪ *Kontributet e detyrueshme per sigurimet shoqerore*

Shoqeria paguan vetem kontributet per sigurimet e detyrueshme shoqerore qe sigurojne pension per punonjesit. Qeveria shqiptare eshte pergjegjese per caktimin e minimumit te kontributit per sigurimet shoqerore ne Shqiperi sipas nje plani pensioni bazuar ne kontribute. Kontributet e shoqerise ne planin e pensionit jane pasqyruar ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve kur ndodhin.

▪ *Leje vjetore e paguar*

Shoqeria njih si detyrim vleren e paskontuar te kostove te cmuara lidhur me lejen vjetore per tu paguar ne kembim te sherbimit te punonjesit per periudhen e perfunduar.

k) *Ngjarje pas mbylljes se Pasqyrave Financiare*

Shënimet shpjeguese janë pjesë integrale e pasqyrave financiare



Ngjarjet pas dates se bilancit qe permbajne informacion shtese te Shoqerise, ne daten e Bilancit Kontabel (ngjarjet rregulluese) jane reflektuar ne Pasqyrat Financiare. Ngjarjet pas bilancit qe nuk jane ngjarje rregulluese paraqiten te shpalosura ne shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare kur jane materiale.



Ngjarjet pas dates se bilancit qe permbajne informacion shtese te Shoqerise, ne daten e Bilancit Kontabel (ngjarjet rregulluese) jane reflektuar ne Pasqyrat Financiare. Ngjarjet pas bilancit qe nuk jane ngjarje rregulluese paraqiten te shpalosura ne shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare kur jane materiale.



3. Aktivet Afagjate Materiale (AAM)

	Toka	Ndertesa dhe insatalime	Makineri Dhe Pajisje	Mjete Transporti	Pajisje Elektronike	Pajisje Zyrash	Aktive ne Proces	Totali
Vlera Bruto								
31 Dhjetor 2013		28.056.000	127.433.701	5.845.383	46.567.178			207.902.262
Shtesa			0	0	7.153.461			7.153.461
Transferime								0
Pakesime								0
31 Dhjetor 2014	0	28.056.000	127.433.701	5.845.383	53.720.639	0	0	215.055.723
Amortizimi Akumuluar								
31 Dhjetor 2013		7.843.139	73.543.663	3.370.471	31.077.746		0	115.835.020
Shtesa		202.129	5.389.004	494.922	1.349.070			7.435.125
Pakesime								0
31 Dhjetor 2014	0	8.045.268	78.932.667	3.865.393	32.426.816	0	0	123.270.145
Vlera Neto								
31 Dhjetor 2013	0	20.212.861	53.890.038	2.474.912	15.489.432	0	0	92.067.242
31 Dhjetor 2014	0	20.010.732	48.501.034	1.979.990	21.293.823	0	0	91.785.578

AAJM

31.12.2014
440.428

31.12.2013
440.428



Shënimet shpjeguese janë pjesë integrale e pasqyrave financiare

4. Inventare

Inventaret te dates 31.12. 2014 krahasuar me 31.12.2013:

	<u>31.12.2014</u>	<u>31.12.2013</u>
	ne Lek	ne Lek
Lendet e para	87.129	87.129
Inventari imet	1.557.941	1.557.941
Mallra per rishitje	5.937.280	5.937.280
Parapagesat per furnizime	0	0
	<u>7.582.350</u>	<u>7.582.350</u>

5. Llogari të Arketueshme dhe tjera të Arkëtueshme (afatshkurter)

Llogari te tjera te Arketueshme te dates 31.12. 2014 krahasuar me 31.12.2013:

	<u>31.12.2014</u>	<u>31.12.2013</u>
	ne Lek	ne Lek
Kliente per mallra,produkte e sherbime	66.608.922	59.967.696
Te drejta e detyrime te tjera	2.769.965	878.094
Tatim mbi fitimin	755.120	1.053.030
Te drejta per tu arketuar	8.737.559	33.000.000
	<u>78.871.566</u>	<u>94.898.820</u>

6. Mjetet Monetare

Mjete Monetare te dates 31.12. 2014 krahasuar me 31.12.2013:

Gjendja e likuiditeteve rakordon me shumen e Statement te bankave dhe gjendjes se arkes ne 31.12.2014 . Shoqeria ka llogari bankare ne Leke dhe Euro

	<u>31.12.2014</u>	<u>31.12.2013</u>
	ne Lek	ne Lek
Mjete monetare ne Banke	765.097	3.070.580
Mjete monetare ne Arke	1.363.662	2.472.502
	<u>2.128.759</u>	<u>5.543.082</u>

7. Kapitali Aksioner

Struktura e aksioneve eshte si vijon:



31.12.2014

Aksionere	Nr.Pjeseve	Vlera nominale e aksionit	Struktura e Kapitalit regjistruar	Kapitali i aksionar
Zhuljeta Lamaj	28.117	1.000	20%	28.117.000
Zyhra Hamiti	56.235	1.000	40%	56.235.000
Mirela Meraj	56.235	1.000	40%	56.235.000
	140.587		100%	140.587.000

140.587.000,00

31.12.2013

Aksionere	Nr.Pjeseve	Vlera nominale e aksionit	Struktura e Kapitalit regjistruar	Kapitali i aksionar
Zhuljeta Lamaj	42.795,90	1.000,00	20%	42.795.900,00
Zyhra Hamiti	17.090,80	1.000,00	40%	17.090.800,00
Mirela Meraj	884,27	1.000,00	40%	884.270,00
	60.770,97		100%	60.770.970

8. Llogari te Pagueshme (Furnitor dhe Overdraft)

Llogarive te pagueshme (Furnitor dhe OD) te dates 31.12. 2014 krahasuar me 31.12.2013:

	<u>31.12.2014</u> ne Lek	<u>31.12.2013</u> ne Lek
Over-draft Soc.Gen	12.591.589	15.337.638
	<u>12.591.589</u>	<u>15.337.638</u>



	<u>31.12.2014</u>	<u>31.12.2013</u>
	ne Lek	ne Lek
Te pagueshme ndaj furnitoreve	15.536.467	29.718.979
	<u>15.536.467</u>	<u>29.718.979</u>

9. Llogari te Pagueshme ndaj Punonjesve

Llogari te Pagueshme ndaj punonjesve te dates 31.12. 2014 krahasuar me 31.12.2013:

	<u>31.12.2014</u>	<u>31.12.2013</u>
	ne Lek	ne Lek
Te pagueshme ndaj punonjesve	1.806.300	1.792.523
	<u>1.806.300</u>	<u>1.792.523</u>

10. Detyrime Tatimore dhe Sigurime

Detyrime Tatimore dhe sigurime shoqerore dhe shendetsore te dates 31.12. 2014 krahasuar me 31.12.2013:

	<u>31.12.2014</u>	<u>31.12.2013</u>
	ne Lek	ne Lek
Detyrime per Sigurime Shoq.Shend.	555.865	469.548
Detyrime tatimore per TAP-in	257.616	218.254
Detyrime tatimore per Tatim Fitimin	0	0
Detyrime tatimore per Tvsh-ne	223.924	168.432
Detyrime tatimore per Tatimin / Burim	0	0
	<u>1.037.405</u>	<u>856.234</u>

11. Llogari te Tjera te Pagueshme

Llogarive te Tjera te Pagueshme te dates 31.12. 2014 krahasuar me 31.12.2013:

	<u>31.12.2014</u>	<u>31.12.2013</u>
	ne Lek	ne Lek
Detyrime te tjera afatshkurter	207.307	207.307
Parapagime te marra	1.471.456	25.000
	<u>1.678.763</u>	<u>232.307</u>

Shënimet shpjeguese janë pjesë integrale e pasqyrave financiare



12. Të Ardhurat Neto

	<u>31.12.2014</u>	<u>31.12.2013</u>
	ne Lek	ne Lek
Shitje neto	73.230.341	65.309.917
	<u>73.230.341</u>	<u>65.309.917</u>

13. Shpenzime Tjera

	<u>31.12.2014</u>	<u>31.12.2013</u>
	ne Lek	ne Lek
Qera	-3.553.831	-3.731.066
Energji + uji	-7.929.384	-8.063.340
Punime dhe sherbime N/Kontraktore	-3.892.438	-3.495.503
Shpenzime profesionale	0	-234.052
Mirembajtje dhe riparime, siguracione	-219.642	-126.496
Shpenzime per zyre	0	-131.396
Noterizime , kancelari	-90.787	-64.776
Shpenzime udhetim e dieta	0	0
Shpenzime postare e telekom	-716.322	-1.621.628
Shpenzime transporti, karburant	-308.391	-1.023.200
Taksa vendore, tatime dhe te ngjashme	-8.334.873	-8.333.983
Komisione bankare ,te tjera	-6.595.043	-3.506.193
	<u>-31.640.711</u>	<u>-30.331.633</u>

14. Shpenzimet per Personelin

	<u>31.12.2014</u>	<u>31.12.2013</u>
	ne Lek	ne Lek
Pagat e personelit	-26.309.374	22.556.976
Shpenzimet per sigurime shoqerore e shendetesore	-3.566.310	-3.151.513
Shpenzime te tjera per personelin	0	0
	<u>-29.875.684</u>	<u>-25.708.489</u>

15. Shpenzimet per Amortizimin dhe Zhvleresimi

	<u>31.12.2014</u>	<u>31.12.2013</u>
	ne Lek	ne Lek
Amortizimi dhe Zhvleresimet	-7.435.125	-6.082.599
	<u>-7.435.125</u>	<u>-6.082.599</u>



16. Te Ardhura dhe Shpenzime Financiare (Neto)

	31.12.2014	31.12.2013
	ne Lek	ne Lek
Te ardhurat dhe Shpenzimet nga interesat	-445.907	-1.474.656
Fitimet dhe Humbjet nga kursi kembimit	1.563	-2.339
Te ardhura dhe shpenzime te tjera financiare	0	-8.315
	<u>-444.344</u>	<u>-1.485.310</u>

17. Rezultatit Tatimore dhe Tatimi mbi Fitimin

	31.12.2014	31.12.2013
	ne Lek	ne Lek
Fitimi (humbja) para tatimit	3.834.477	1.701.886
<i>Nga te cilat:</i>		
Shpenzime te pajohura		
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	- 297.910,00	-
Fitim (humbje) neto e vitit financiar	<u>3.536.567</u>	<u>1.701.886</u>

18. Palet e lidhura

Kompensimi i manaxhereve kryesore te Shoqerise

Palet qohen te lidhura kur njera prej tyre ka mundesine te kontrolloje palet e tjera ose te ushtroje ndikim domethenes ne vendim-marrjen financiare dhe operacionale te tyre. Shoqeria konsideron si pale te lidhura drejtorin e saj dhe anetaret e keshillit mbikqyres.

19. Angazhime dhe detyrime te kushtezuara

Çështje gjyqësore

Me 31 Dhjetor 2014 Shoqeria nuk ka asnje çështje gjyqësore te hapur kundrejt saj apo nga ajo, qe mund te kerkoje rregullime te ketyre pasqyrave financiare.

Detyrime tatimore

Librat e Shoqerise nuk jane audituar nga organet tatimore per periudhen 2014. Si rrjedhoje detyrimet tatimore nuk mund te konsiderohen perfundimtare. Detyrime te mundshme qe mund te rezultojne nga nje auditim i organeve tatimore nuk mund te maten ne menyre te besueshme.

20. Ngjarje pas dates se bilancit

Me 31 Dhjetor 2014 ne daten e pasqyrave financiare dhe deri ne daten e aprovimit te tyre nuk ka ngjarje rregulluese te reflektuara ne pasqyrat financiare ose ngjarje qe jane materialisht te rëndësishme per te paraqitur ne keto pasqyra.

Administratori

Hartuesi i Pasqyrave Financiare

Tiranë, më 1 /2015

Shënimet shpjeguese janë pjesë integrale e pasqyrave financiare

18

